

V E N D I M
Nr. 240, datë 6.6.2001

**PËR MËNYRËN E NDARJES SË TË ARDHURAVE QË VIJNË NGA MARRËVESHJET
E QIRASË SË "PERSONAVE TË STIMULUAR" NË FUSHËN TURISTIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 14 dhe 21 të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe privatizimit", ndryshur me ligjet përkatëse, dhe të shkronjës "ç" të nenit 7 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", me propozimin e Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të ardhurat e realizuara nga marrëveshjet e qirasë, të lidhura ndërmjet Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe "personave të stimuluar" në fushën e turizmit, të ndahen si më poshtë vijon:

- 30 për qind në buxhetin e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit;
- 70 për qind në Buxhetin e Shtetit.

2. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit t'i përdorë këto fonde për zhvillimin e infrastrukturës së turizmit dhe për promocion.

3. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko